



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 01 korrik 2020, në mbledhjen e tretë (3) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; znj. Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom dhe z. Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së; z. Zaim Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të KKS-së këtë vit. Fillimisht dua të ju përshëndes të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë kësaj periudhe të pandemisë. Jemi prej komunave të para në Kosovë që zyrtarisht jemi shpallë si komunë free dhe kjo vërtetë na bën të kënaqur të gjithëve.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27 maj 2020

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, kanë rrjedhur disa gabime teknike, në fund të faqes 3 të procesverbalit z. Nexhip Jaha figuron si përfaqësues i KFOR-it, të

korrigjohet, duhet të jetë i FSK-së, pastaj një fjalë në faqen 4 në fillim të diskutimi në vend të *mjerimin e rastit...*, duhet të jetë *lajmërimit e rastit...*

z. Bekim Zogiani, theksoi, të diskutimi im në faqen 2 të procesverbalit, në vend të e *...kemi kaluar sfidën*, duhet të jetë... *jemi duke kaluar me sfidën...*

Procesverbali u miratua njëzëri, me korrigjimet e bëra.

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, sa i përket situatës së sigurisë në Komunën e Podujevës, vlerësohet e qetë, nuk ka ndonjë rast që e prishë rendin dhe qetësinë në përmasa të mëdha, po ashtu nuk kemi informacione se mund të ketë ndonjë protestë apo organizim që do të prishte rendin dhe qetësinë publike. Në përgjithësi për gjashtëmujorin e vitit 2020 kemi 598 raste të evidentuara, ku krahasuar me periudhën e njëjtë 2019 ku kemi pasë 505 raste, që do të thotë kemi ngritje të rasteve. Kjo është për shkak se gjatë pandemisë janë iniciuar disa raste të cilat shumica prej tyre kanë të bëjnë për parandalimin e përhapjes së covid 19. Si Stacion policor jemi duke u angazhuar në maksimum në ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët, sidomos tani që është e theksuar edhe pandemia me covid 19, verifikimet, angazhimet edhe për rastet e personave të cilët janë në izolim. Deri më tani kemi, pa tri familjet e rasteve të fundit i kemi 217 persona në izolim, të cilët i vizitojmë dhe i kontaktojmë për të verifikuar se a janë duke iu përmbajtur rekomandimeve të IKSHPK-së, ndërsa sa i përket numrit të personave aktiv në territorin e Komunës, janë 32. Këto të dhëna janë marrë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Është një angazhim bukur i madh i njëjësive policore. Po ashtu gjendja në trafik pas lirimit të masave është rënduar që kërkon angazhim të shtuar.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, falënderojmë Komandantin, vetëm desha të shtojë se sipas raportit të fundit të QKMF-së dhe epidemiologes sot janë 28 raste aktive, sepse 4 raste janë shëruar, kanë dalë nga vetizolimi, prej tyre 4 janë në klinikën infektive, 4 në klinikën pulmologjike dhe gjendja e tyre shëndetësore është stabile, ndërsa 20 të tjerë janë në vetizolim. Këtu bëhet fjalë për ata që kanë rezultuar pozitiv. Por nuk është me rëndësi numri, sepse ne duhet të merremi me secilin rast, duhet t'i ofrojmë shërbimin sikurse u kemi ofruar deri më tani, si me kontrolle mjekësore, qoftë me pako ushqimore dhe higjienike, dezinfektime të hapësirave ku jetojnë. Ne si Shtab emergjent tërë kohën jemi në menaxhim dhe monitorim të këtyre rasteve. Shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë anëtarët e Shtabit dhe të tjerët që 24 orë jemi on-line të informuar për secilin rast. Dje ishte për vizitë Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtori i IKSHPK-së dhe u përcjell edhe juve mirënjohjet gjegjësisht përgëzimet që i kanë bërë Podujevës, Shtabit Emergjent dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës për menaxhim, sipas tyre të shkëlqyer të pandemisë dhe kjo vërtetë na bënë që të ndihemi krenar. Numri i të prekurve në raport me numrin në rritje në Kosovë, konsideroj që në Podujevë është numër i menaxhuar.

z. Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së, sa i përket gjendjes së sigurisë, konsiderohet e qetë dhe stabile. Në territorin e Komunës së Podujevës, në këtë periudhë kohore, FSK nuk ka pas ndonjë aktivitet, mirëpo e dimë se kjo Komunë ofron një terren të

përshtatshëm gjeografik për ushtrime të ndryshme ushtarake dhe në të ardhmen e afërt shpresojmë që të kemi ushtrime të ndryshme dhe trajnime të përbashkëta me institucionet tjera në Komunë, por për momentin pasi që kemi një armik të përbashkët covid 19 edhe ne si FSK jemi të prekur me 26 pjesëtarë, që 7 prej tyre janë nga Komuna e Podujevës. Të prekurit janë në vetizolim dhe janë marrë masat e duhura nga institucioni. Kemi informata që ekipet mjekësore dhe Komuna e Podujevës është përkujdesur maksimalisht për ta dhe Nënkryetari i ka vizituar personalisht dhe e përgëzoi për punën që ka bërë. Disa njësi të FSK-së gjatë kësaj periudhe të pandemisë kanë qenë aktive 24 orë, kështu që jemi duke menaxhuar situatën dhe jemi në vëzhgim të pjesëtarëve që të respektojnë rregullat, sepse lufta më e mirë që ne e konsiderojmë tani për tani është të respektojmë rekomandimet që dalin nga IKSHP-ja.

Përfaqësuesi i KFOR-it, nga ana e KFOR-it vlerësojmë gjendjes e sigurisë të qetë dhe të sigurt dhe s'ka ndonjë kërcënim apo indikacion që do të ndikojë në gjendjen e sigurisë, apo do të rrezikojë lirinë e lëvizjes, e cila mbetet edhe brenga jonë më e madhe. Stacioni i Policisë në Podujevë në krye me Komandantin Bekim Zogiani është shumë mirë duke menaxhuar situatën e sigurisë, e vlerësojmë dhe çmojmë punën e tyre. Edhe ne si pjesëtarë të KFOR-it na brengos gjendja me covid 19. Me urdhër të Komandantit të KFOR-it ne duhet t'i ndjekim rregullat dhe rekomandimet e dhëna nga institucionet kompetente si në Kosovë por edhe ato brenda KFOR-it. Këto masa dhe rregulla në një mënyrë ndikojnë edhe në punën tonë, por punët jemi duke i kryer përmes tel. dhe e-maileve. KFOR-i është në kontakt të përhershëm me institucionet e Kosovës. Hapat që ndërmerren bëhen në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet lokale të shëndetësisë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, shfrytëzoi rastin të falënderoj përfaqësuesin e KFOR-it që javën e kaluar ishin në QKMF dhe dhanë një donacion të vlefshëm, mjete mbrojtëse për mjekët dhe personelin shëndetësor. Nëse nuk keni diçka lidhur me këtë pikë, atëherë kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë lidhur me gjendjen e krijuar nga Pandemia - Covid 19 në Komunën e Podujevës

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, të shohim për aktivitetet që janë ndërmarrë në mes këtyre dy takimeve. Fjalën për këtë ia kaloi Drejtorit të DSHMS z. Zaim Thaçi, **z. Zaim Thaçi**, në komunën e Podujevës si dhe në komunat tjera të prekura, po ballafaqohemi me situatën epidemiologjike, me një intenzitet thuajse të shtuar ditëve të fundit, e kam fjalën për numrin e pacientëve pozitiv, por me një vilulencë të zvogëluar, mund të themi. Numri i qytetarëve të Komunës së Podujevës të testuar arrin mbi 300 brenda periudhës që nga momenti kur është shpallur si pandemi. Drejtori foli për numrin e rasteve aktive, rastet e konfirmuara pozitive dhe të shëruara, si dhe gjendjen shëndetësore të të prekurve. Aktivitetet e Drejtorisë së Shëndetësisë janë të shtrira në dy fusha, në komponentë shëndetësore në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në familjet e atyre qytetarëve të cilët janë të prekur me covid 19 dhe komponentë sociale. Aktivitetet shëndetësore kryesisht janë të fokusuara në vizitë mjekësore, dezinfektimin e hapësirave të banimit, gjithëherë të mbështetura nga njësitë policore, ndërsa komponenta sociale në ofrimin permanent të pakove ushqimore dhe higjienike për familjet të cilat janë konfirmuara pozitiv me virusin covid 19. Dmth aktivitetet e Drejtorisë në përgjithësi janë duke përfshirë komplet strukturën e shtabit komunal nën udhëheqjen e Nënkryetarit të Komunës. Rekomandimet e IKSHP-së dhe të OBSH-së do të gjejnë gjithmonë hapësirë

me qëllim që ta kalojmë këtë sfidë. Përfundimisht mendoj se situata epidemiologjike në Komunën tonë është duke u menaxhuar.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, jam munduar ta ndaj një lajmë të mirë me qytetarët e Komunës së Podujevës, pas vizitës së djeshme që kemi pasur, sikurse e ceka më lartë të Ministrit të Shëndetësisë, Drejtorit të SHSKUK dhe Drejtorit të IKSHPK, që sipas kërkesës së QKMF-së që të shikohen mundësitë që mostrat për testet covid 19 të bëhen në Podujevë, është lajm i mirë se kjo është lejuar dhe prej ditës së sotme testimet për covid 19 ofrohen edhe në Komunën e Podujevës, por që është e nevojshme disa ditë për trajnimin e personelit shëndetësor. Është e vetmja komunë në Kosovë që nuk është qendër rajonale që i lejohej kjo mundësi, sepse deri më tani këtë e kanë pasur vetëm Prishtina dhe spitalet rajonale. Testet do t'u mundësohen atyre personave të cilët vlerësohen nga ekspertët shëndetësor. Për këtë falënderoj Ministrin e Shëndetësisë por dhe Drejtorin e IKSHPK-së që miratuan kërkesën tonë të djeshme që kjo punë të kryhet në Podujevë.

z. Zaim Thaçi, lidhur me lajmin e cekur nga Nënkyetari dua të shtoj se marrja e mostrave do të bëhet nga QKMF, ndërsa përpunimi i tyre kryhet në laboratorin e mikrobiologjisë në Prishtinë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Po shihet këto dy javët e fundit, e në veçanti prej 1 qershorit kur kemi kaluar në fazën e tretë të lehtësimeve të mëdha që ishin të imponuara nga Ministria ka rritje të numrit të rasteve, mirëpo kjo po ndodhë edhe në pjesë tjera të Evropës dhe në rajon. Nuk besoj se duhet të jetë tepër shqetësuese, shqetësuese duhet të mbetet për ne si institucione të bashkëpunojmë me qytetarët në mënyrë që ata t'i respektojnë rregullat, e në veçanti bartjen e maskës mbrojtëse dhe sigurisht mbetet shqetësim frekuentimi i objekteve hoteliere. Sikurse keni parë kemi vendosë rregulla në bazë të udhëzimeve edhe në hyrje të objektit të Komunës, të gjithë ata që vijnë për të kryer shërbime duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse. Na duhet një bashkëpunim ndër institucional me policinë, Inspeksionin, QKMF-në dhe të gjithë akterët e tjerë, në veçanti Shtabi Emergjent dhe të përçojmë mesazhe të qarta te qytetarët për rrezikun e kthimit të vrullshëm të covid 19, sepse është krijuar bindja se me ngritjen e temperaturave covid 19 do të eliminohet, e që po dëshmohej se nuk është e vërtetë. Sfidë e veçantë për institucionet relevante komunale në menaxhimin e kësaj periudhe do të jetë ardhja e bashkatdhetarëve tanë nga jashtë. Do të duhet që edhe njëherë t'i kthehemi periudhës së muajit mars, pa panik, por të jemi më shumë të vetëdijesuar se rreziku nga covid 19 nuk ka kaluar dhe kjo po vërehet me shifra. Në bazë të shifrave nuk do të thotë që gjendja reale është kështu, sepse po të kishte më shumë testime edhe ne do të kishim më shumë raste pozitive. Statistikave duhet t'u përmbahemi por nuk jam aspak ithtar i asaj të krijojmë panik te qytetarët, përkundrazi duhet ta minimizojmë dhe ta trajtojmë situatën me seriozitet sepse veçse po shihen pasojat. Disa shtete përreth por edhe disa evropiane nuk i kanë hapur kufijtë për shtetasit kosovarë dhe kjo lidhet ngushtë me masat që i merr Qeveria dhe masat komunale për luftimin dhe parandalimin e covid 19. Unë e hap debatin.

z. Durim Salihu, dua të ju njoftoj se dje me urgjencë na është adresuar thirrja prej Ministrisë së Tregtisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe përfaqësuesve të MPB dhe kemi mbajtur një takim me ndërmjetësim të AKK lidhur me masat mbrojtëse për parandalimin e covid 19. Në atë takim ndër tjera është shtruar kërkesë për rritjen e stafit, çoftë të inspektorëve ashtu edhe të numrit të zyrtarëve policor. U njoftuam se 200 inspektorë pritet shumë shpejtë të procedohen dhe të kyçen pasi të kryhen procedurat. Ne kërkuam që të ndahet edhe një buxhet për çdo Komunë, që t'i mbulojë shpenzimet Niveli

qendror, në mënyrë që të marrim punëtorë me kontratë për shërbime të veçanta. Por ajo që vlen për të theksuar është çështja e gastronomisë, të cilat brenda javës janë në pritje për marrjen e lejes për organizimin e ahengjeve, dasmave dhe festave të ndryshme, e që sipas Ministrit të Ministrisë së Tregtisë ato mund të ndodhë që të pezullohen në afat të pacaktuar. Në fazën finale është drafti i shqyrtimit të masave shitesë për parandalim të përhapjes së covid 19.

Mbesim me shpresë që situata me covid 19 nuk do të përshkallëzohet.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

4. Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të komunës

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, sikurse jeni në dijeni jemi në mes të procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2020-2023, besoj se deri në fund të muajit gusht shumicën e punëve do t'i përfundojmë, kemi mbajtur edhe debate me qytetarë edhe pse ka qenë pak problem për shkak të pandemisë, por kemi ofruar mundësinë që qytetarët të bëjnë kërkesa nëpër drejtori të caktuara për projekte, për të cilat ata mendojnë se janë të rëndësishme, por këtu e kemi fjalën për projekte që mund të ndikojnë në përmirësimin e sigurisë siç janë ndriçimi publik, rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave, kamerat e vëzhgimit dhe projektet tjera që ju e shihni që mund të jenë me ndikim pozitiv në siguri. Mund të kemi ndonjë propozim edhe nga fusha e Policisë, nga FSK-ja, KFOR-i dhe subjekte tjera.

Për këtë temë në mënyrë më të detajuar do ju njoftojë Drejtori i Drejtorisë së SHPM.

z. Faik Muçiqi, theksoi, në kuadër të udhëzimit Administrativ i cili i referohet këtij Këshilli, parashihet që ky këshill mund t'u propozojë Drejtorive përkatëse projekte të infrastrukturës dhe shërbimeve që kanë ndikim drejtpërdrejtë në sigurinë e tyre, ku kryesisht janë trotualet, ku jena duke vazhduar këtë vit dhe kemi planifikuar bukur shumë edhe vitin e ardhshëm, mbi 200,000 €, pastaj ndriçimi publik që këtë vit janë të buxhetuara 35 km por brenda pak kohe do të jenë edhe 7 km, ndërsa për vitin e ardhshëm i kemi 40 fshatra që fillojnë me ndriçime publike në rrugët kryesore. Nga kjo qytetarët sigurisht do të ndihen më mirë po ashtu edhe policia do ta ketë më lehtë, sepse ku ka munguar apo është prishur ndriçimi publik rastet e vjedhjeve kanë qenë më të shpeshtuara. Pastaj kemi projekte të urave dhe zgjerim të shtratit të lumenjve. Dje kemi kaluar draftin e parë në Kuvend të projekt buxhetit, mirëpo nëse ju mendoni të përfshihet edhe ndonjë projekt që është më specifik, qoftë nga fusha e shërbimeve publike, urbanizmi apo drejtoritë tjera, ju na propozoni dhe këtë mund ta bëni deri më 30 shtator, kur edhe është afati i fundit i miratimit të projektbuxhetit të Komunës në Kuvend. Vazhdimi i vendosjes së kamerave është shumë me rëndësi dhe nuk jam në dijeni se Drejtoria e Administratës a ka planifikuar, sepse siç e shihni pikën e dobët që e kemi te drithniku në qytet, pran hekurudhës, ku faktikisht aty çdo ditë hedhen mbeturina dhe gjendja është e pa tolerueshme, pra është mirë që këtë vit ta shqyrtojmë me Policinë dhe Inspeksionin, pra ta vendosim një kamerë vëzhgimi dhe të veprohet me penalizime ndaj qytetarëve të papërgjegjshëm.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, në lokacionin e përmendur nga Drejtori, kam parë se gjendja është shqetësuese nga grumbullimi i mbeturinave. Kompania ka bërë

pastrimin mirëpo kjo është duke vazhduar edhe pse aty ka kontejnerë të mjaftueshëm dhe zbrazen rregullisht. Deri sa të vendoset sistemi i kamerave inspeksioni të monitorojë hapësirën, nëse është e nevojshme të aplikohet edhe puna në dy ndërrime, në mënyrë që të fillohet me shqiptimin e gjobave mandatore por edhe të dënimeve tjera, siç parashihet edhe me Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave dhe në Rregulloren për mbrojtjen e mjedisit. Nëse nuk fillojmë seriozisht me u marrë me këtë pikë të mbeturinave dhe pikat tjera periudha e verës do të na shkaktojë shumë telashe, kështu që inspeksioni të merr masa e nëse është nevoja do të marrim edhe punëtorë shtesë me kontratë për shërbime të veçanta. Kërkoj që nga sot institucionet përkatëse të merren me atë pikë seriozisht, nëse ka nevojë për mbështetje është edhe Policia e Kosovës. Të njëjtën gjë e kemi edhe te Liqeni i Batllavës. E kemi pas në plan të angazhojmë dy persona me kontrata të veçanta, që do të kujdeseshin për mirëmbajtjen e pjesës së Liqenit gjatë periudhës verore dhe këtë duhet ta bëjmë, sepse edhe atje është një pamje e tmerrshme, shokuese nga mbeturinat. Këtë gjendje e bëjnë vet qytetarët që vizitojnë atë pjesë, i hedhin mbeturinat dhe pastaj i fotografojnë dhe i postojnë. Sigurisht e dini se Liqeni i Batllavës nuk është përgjegjësi e Komunës së Podujevës, por është pronë e KEK-ut dhe aset i Qeverisë. Megjithatë ne si Komunë edhe pse nuk e kemi në menaxhim Liqenin dhe që nuk e kemi pas, me buxhetin modest që e kemi vazhdimisht jemi munduar duke angazhuar punëtorë për të mos lënë grumbullimin e mbeturinave. Kjo do të ishte dashur me qenë përgjegjësi e inspektorëve të ambientit të Qeverisë që do të duhej të merreshin seriozisht me Liqenin e Batllavës.

z. Nuhi Selimi, theksoi, në mbledhjen e fundit të KLSB- Orllan ku përfshinë 19 fshatra, përfaqësuesi i fshatit Bellopojë për sigurinë në rrugë afër Shkollave (Luzhan dhe Bellopojë), shtroi kërkesë për vendosjen e pengesave në rrugë. Pastaj në fshatin Orllan edhe pse mendoj se është bërë e tepërte duke e përmendur, çështja e trotuarit te ura, nuk ka ndonjë lëvizje. Përveç kësaj kam një kërkesë e që është shumë e nevojshme për të vendosur 2-3 pika të kamerave në Orllan, prej tyre një në udhëkryq, një poshtë te pishat ku u përmend pika e mbeturinave dhe një në rrugën në drejtim të memorialit “Zahir Pajaziti”. Mbeturinat nuk janë të banorëve të fshatit Orllan, por nuk mund të thuhet edhe e vizitorëve edhe pse ka të papërgjegjshëm edhe prej tyre dhe hedhin, por ato kryesisht janë nga personat që kanë ardhur dhe kanë investuar në atë pjesë, ku ndërtojnë vikendica dhe pas pastrimit, i hedhin mbeturinat, pra nuk mund të adresohet kjo te të gjithë vizitorët, sepse prej tyre ka shumë të ndërgjegjshëm, shumë të kulturuar. Kërkoj edhe prej Inspektoriatit dhe Policisë që të monitorojnë ambientin në atë zonë në mënyrë permanente sidomos gjatë kohës së mëngjesit dhe në mbrëmje, koha kur hedhen mbeturinat. Kam edhe një vërejtje prej KLSB-së, personat që therin kafshët dhe shpezët, mbeturinat i kanë hudhë në lokacionin në mes fshatit Barainë dhe pendës, këto janë shqetësime të banorëve edhe për shkak të rrezikut nga qentë e grumbulluar aty. Autoritetet komunale duhet të dalin dhe të marrin masat ligjore. Sa i përket infrastrukturës rrugore, kërkesa është që ndriçimi brenda mundësive të shtrihet deri te memoriali “Zahir Pajaziti”. Çështje tjetër është, pasi që pothuajse çdo vit mbytet nga një person në Liqen, është mirë që në saj të bashkëpunimit nga FSK (ekip i shpëtimit) të bëhet një kujdestari, së paku gjatë ditëve të vikendit, sikurse që janë duke qëndruar Ndihma e shpejt dhe ekipi i zjarrfikësve.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, siç e dini zyrtarisht ajo pjesë e territorit të Komunës nuk është vend turistik, nuk është i paraparë Liqeni i Batllavës për not dhe larje por për ujë të pijshëm. Për të vendosur ekiye nënkupton që ajo është e lejuar, e në fakt nuk është e lejuar edhe pse tjetër është që nuk janë shqiptuar gjoba dhe nuk është ndaluar shfrytëzimi. Për të vendosur njësi shpëtimi do të nënkuptohej se ne kemi legalizuar diçka

që nuk është kompetencë e jona. Nëse Qeveria apo Ministria e Ambientit që e ka atë mundësi e lejon shfrytëzimin e liqenit të Batllavës për aktivitete tjera sportive dhe freskuese, atëherë si Komunë mund të shikonim mundësitë se çfarë mund të bëjmë. Ajo mbetet zonë industriale e jo zonë turistike.

z. Qefser Behrami, theksoi, flas në cilësi të përfaqësuesit të fshatrave që i përfaqësoj. Javën e kaluar kemi mbajtur një takim të KLSP në fshatin Kërpimeh, ku përmbledh përfaqësues të 25 fshatrave. Kur trajtohet çështja e keqpërdorimeve, është arsyeja që më ka shtyrë që me OSBE-në të parashtrojmë një kërkesë për vendosje të disa kamerave në Kërpimeh, sepse në rrugën në drejtim të Mitrovicës ka keqpërdorime të ndryshme, ka edhe raste të hyrjes në shkollën e vjetër, e që këto raste edhe janë raportuar. Është pamundësuar të na japin kamerat edhe pse ka qenë në projekt, kamerat kanë qenë të dedikuara nga OSBE për shkollën, por nuk na kanë lejuar. Sa i përket trotuareve është punuar bukur mirë, por mbi varrezat e fshatit Kërpimeh nuk ka trotuare dhe është rrezikshmëri e madhe për shkak të vozitjes së kamionëve dhe automjeteve tjera me shpejtësi të madhe, kryesisht ato automjete janë të ngarkuara me masë drunore. Këto janë shqetësime të madha për ne. Po ndërlihem edhe me pandeminë covid 19, ku i falënderoj banorët e atij rajoni për respektimin e masave të rekomanduara.

Çështja e higjienës dhe mbeturinave, sipas mendimit tim është një zgjidhje adekuate dhe e lehtë, kompanitë që merren me bartjen e mbeturinave të konstatojnë në secilin fshat se kush nuk është përfshirë në sistemin kontraktual për bartjen e mbeturinave dhe është e thjeshtë për të konkluduar se ata që nuk bëjnë pagesën e kryerjes së shërbimit të bartjes së mbeturinave, i hedhin mbeturinat. Çështje tjetër shqetësuese është ndërtimi i pendave, si të tilla nuk janë për t'u ndërtuar në vendin tonë, por fjala vjen në shtete evropiane të cilët janë të vetëdijshëm dhe nuk hedhin gjithçka sikurse që ndodhë te ne. Si rezultat i kësaj penda është bllokuar dhe ka qenë afër të dal nga shtrati dhe të përmbytë lagjen pran. Për këtë kam ftuar Drejtorin e DBPZHR dhe e falënderoj për angazhimin e tij por edhe banorët të cilët kanë kontribuar . Është tmerr që lumi Llap të jetë në atë gjendje, nuk është fajtorë kompania sepse ajo e ka zgjeruar, por fajtorë është papërgjegjshmëria jonë. Gjithashtu dua të theksoj se penda nuk është ndërtuara sipas standardeve, shtyllat e ndërtuara janë shkaktarët kryesor të ndaljes së mbeturinave, nuk do të duhej të ishin vendosur. Në këto tri penda nëse nuk ndërmerret diçka në të ardhmen mund të ketë pasoja. Shqetësim tjetër i banorëve është shkatërrimi i pyjeve në mënyrë të vazhdueshme, në masë të madhe është duke u bërë prerja e tyre dhe duke u shkatërruar . Këtu kemi të bëjmë me personat që pothuajse më së paku kanë nevojë, dalin si shkatërruesit më të mëdhenj të pyjeve. Për këtë personalisht e kam lajmëruar policinë kufitare.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, sa i përket pendave , ne i kemi ndërtuar për të mirën e atyre banorëve, të cilat janë dizajnuar nga ekspertë të lëmisë përkatëse dhe ata sigurisht kanë vlerësuar sa është e nevojshme vendosja e shtyllave të pendave dhe sigurisht se ata nuk kanë parashikuar se ne në lum hedhim mbeturina nga më të ndryshmet të cilat e bllokojnë rrjedhën e lumit, por janë dizajnuar me standarde evropiane. Pasojat që shkaktohen janë nga faktori njeri, qoftë me ngushtimin e shtretërve të lumenjve apo me hedhjen e mbeturinave, qoftë për uzurpimin e pronës pran lumit apo përroskës me ndërtime të ndryshme, por ka pas edhe raste edhe të pengimit nga ana e pronarëve të tokave pranë lumit për mos zgjerim të shtratit. Vërtetë kjo është shqetësuese por ne do të marrim masa që të gjitha pengesat sa i përket uzurpimeve dhe shtrembërimit të rrjedhave të lumenjve dhe të përroskave do ti hapim qoftë me pëlqimin e qytetarëve qoftë pa pëlqimin e tyre, sepse nuk mund një mes apo një fshat i tërë të vuaj pasojat e një personi të papërgjegjshëm. Mbetet shqetësuese hedhja e mbeturinave në lumenj, pamja

është e tmerrshme, objekte të ndryshme të hedhura në pjesën e epërme të lumit Llap, por edhe në pjesë tjera. Duhet një koordinim i mirë i Policisë me inspektorët e Komunës për të parandaluar këtë dukuri, duhet të ndalohen dhe të shqiptohen gjobat, sepse ata janë duke shkatërruar ambientin. Janë vetëm dy kompani që janë të licencuar për bartje të mbeturinave, Kompania Rajonale “Pastrimi” dhe Kompania private “Natyra”.

z. Qefser Behrami, dua të theksoj se vetëm ato tri shtylla të betonit të vendosura në penda paraqesin pengesë dhe nuk do të duhej të ishin. Unë pajtoj me atë që theksoi Nënkryetari se kjo është vepër e ekspertëve dizajnues, por siç theksova këto parashihen për vendet përëndimore e jo për te ne.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, shtyllat e pendave janë të domosdoshme sepse çdo derë e pendës prej 6-8 m, e qelikut, është e pamundur të qëndrojë pa pikë mbajtëse, pa shtyllë.

Dua të ju njoftoj se kam një aktivitet tjetër nga ora 11.15, kështu që me kryesimin e mbledhjes do të vazhdoj koordinatori i KKS-së z. Faik Muçiqi.

z. Liman Zeqiri, u hap si temë mbrojtja e ambientit e cila zgjon kureshtje dhe debat dhe faktikisht edhe ligjërisht me u implementua. Jam i bindur se 90% e deponive ilegale janë në pronat publike, janë të uzurpuara. Drejtoria e Pronës kadastrit dhe Gjeodezisë është mirë që ta ketë një hartë ku do të definoreshin të gjitha pronat publike, në çdo mes dhe ku janë të uzurpuara. Ne jemi në dijeni se ka keqbërës dhe uzurpues, mirëpo së paku të dihet cilët janë. Në ato ambiente po krijohen deponi ilegale dhe po hedhen mbeturina të mëdha dhe po shkaktohen pasoja. Nëse do të kishim një gjendje faktike për të gjitha pronat atëherë Komuna do ta kishte më lehtë menaxhimin, apo lidhja zingjirore e drejtorive përkatëse dhe shumë më lehtë do të kishte vepruar edhe Drejtoria e Inspeksionit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në fushën e vet. Këto janë problemet që na përcjellin dhe paraqiten shumë herë edhe si pengesa në implementimin e projekteve për hirë të uzurpuesve. Duhet ta kemi të qartë se duhet respektuar institucioni dhe ligji, persona me vetëdije dhe pavetëdije ose uzurpues me qëllime të caktuara kanë degraduar ambientin dhe tash kërkohet angazhim gradual për mirëmbajtjen e ambientit.

z. Faik Muçiqi, dua të bëjë disa sqarime sa i përket propozimeve të projekteve nga ana e disa anëtarëve të Këshillit. Në fshatin Orllan këtë vit është vazhdimi i trotuarit në gjatësi 800 m deri te restoranti ku është bërë ndriçimi publik. Sa i përket urës ajo nuk mund të zgjerohet, është shumë e gjatë dhe nuk kemi mundësi, i jemi drejtuar Ministrisë së infrastrukturës për zgjerim. Ndriçimin publik këtë vit e kemi planifikuar një pjesë nga pishat rruga te lagja Musa, ndërsa për vitin e ardhshëm mendojmë ta shtrijmë dhe mbulojmë pjesën te Memoriali i dëshmorit “Zahir Pajaziti”.

Në fshatin Kërpimëh kemi paraparë shtrirjen e trotuarit deri te rruga për në fshatin Pakashticë me buxhet të vitit të ardhshëm. Për propozime tjera eventuale ka kohë deri në shtator, kur miratohet edhe projektbuxheti i Komunës. Nëse nuk keni diçka tjetër kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë për dukuritë negative dhe masat sensibilizuese kundër tyre (përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna etj.)

z. Faik Muçiqi, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, për periudhën raportuese kemi ngritje prej 18% të rasteve, mirëpo sa i përket rasteve ndaj pronës, konkretisht vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda kemi

rënie prej 6.87%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, do të thotë 174 raste vitin e kaluar, ndërsa 162 raste këtë vit në periudhën e njëjtë kohore.

Sa i përket rasteve të dhunës në familje kemi rënie prej 13 %, do të thotë 43 raste sa kanë qenë vitin e kaluar, janë 37 raste këtë vit.

Dukuria e narkotikëve është shqetësuese, kemi një ngritje prej 160% të rasteve këtë vit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, prej 2 rasteve sa kanë qenë në gjashtëmujorin e parë 2019, në gjashtëmujorin e parë 2020 ka shkuar në 13 raste.

Sa i përket personave të arrestuar, kemi 14 % më shumë arrestime, prej 97 rasteve 2019, në 154 këtë vit. Armë të konfiskuara kemi 14 raste 2019, 16 raste 2020.

Aksidentet në komunikacion, duke përfshirë me dëme dhe lëndime kemi një rënie të lehtë 1.21 %. Në shqiptimin e gjobave në komunikacion kemi ngritje prej 23%, duke mos llogaritur periudhën e pandemisë gati 3 muaj, do të thotë që çështja e trafikut, parkingjeve për të mos i rënduar qytetarët nuk ka qenë prioritet i yni. Tash veç kemi filluar t'i lirojmë rrugët dhe trotualet prej parkimeve të parregullta.

Në përgjithësi situatën e kemi në kontroll dhe në mënyrë më pozitive se vitin e kaluar, pjesën e parë.

z. Zaim Thaçi, për hirë të situatës që gjendemi në pandemi me covid19, përvojat tona kanë qenë në aktivitete të përbashkëta ekskluzivisht me njësitë policore të cilat kanë qenë të destinuara në kampanja të caktuara senzibilizuese, nëpër shkolla dhe komunitet të cilat mendoj se i kanë pezullua për hirë të situatës në të cilën jemi, andaj aktivitete në senzibilizim nuk kemi pas kohëve të fundit, por absolutisht mbetet në të ardhmen për të vazhduar bashkëpunimin që e kemi pasur institucionet shëndetësore me njësitë e veçanta të Policisë së Kosovës. Mendoj që kemi përvoja të mira të aktiviteteve senzibilizuese, përndryshe për momentin i kemi pezulluar këto aktivitete.

z. Agim Blakçori, Drejtoria e Arsimit në kuadër të masave për parandalimin e dukurive negative ka fuqizimin e organeve qeverisëse, udhëheqëse dhe profesionale të shkollave, organe të cilat kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në luftimin e këtyre dukurive dhe sensibilizimin e nxënësve për rrezikun e këtyre dukurive. Fokus tjetër për Drejtorinë e Arsimit dhe shkollat më saktësisht kemi të bëjmë te fokusimi në çështjet e përmbajtjeve kurrikulare dhe programore ku vlen të theksohet që është lënda e edukatës qytetare që i trajton këto dukuri dhe këto probleme me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë dhe është edhe një pjesë që ne e quajmë si përmbajtje ekstrakurrikulare dhe aty mund të fokusohemi në arritjen e këtyre objektivave, pra në senzibilizimin dhe luftën kundër këtyre dukurive negative. Përveç këtyre rol të rëndësishëm luan edhe Këshilli pedagogjik dhe psikologjik i shkollës, ku aktualisht këtë këshill e kemi të formuar në 4 shkolla, mirëpo këto këshilla i mbështesin edhe shkollat tjera sipas nevojës. Gjithashtu kemi planifikuar që gjatë këtij viti të shtrijmë dhe në 4 shkolla shërbimin psikologjik dhe pedagogjik. Kemi bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës, e cila na mbështet dhe ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në luftimin e dukurisë negative sidomos të vandalizmave dhe të narkomanisë. Shkollat e mesme, por edhe ato të mesme të ulta mund të jenë target i këtyre dukurive, prandaj edhe kemi organizuar takime të ndryshme me Policinë të cilët operojnë afër shkollave, por edhe me Komandantin e Policisë dhe me Drejtorët e shkollave të mesme, ku i kemi trajtuar dhe jemi munduar të gjejmë modalitete në mënyrë që të ballafaqohemi me këtë problem. Gjithashtu kërkojmë edhe nga Drejtoria e Inspeksionit që të vazhdojë me inspektime dhe kontrole në lokalet afër shkollave, sidomos te shkollat e mesme dhe këtyre në qytet, sepse çdo herë ka dyshime se aty mund të zhvillohen veprimtari të paligjshme dhe të bashkëpunojnë me Policinë që të mbështesin njëra tjetrën, me qëllim që të eliminojmë dhe të mos na përsëriten këto

dukuri. Në luftimin e kësaj dukurie krahas rolit edukativ që luan shkolla kemi nevojë për mbështetje të fuqishme të policisë, inspeksionit dhe të institucioneve tjera, pastaj organizatat e ndryshme joqeveritare, bashkësitë fetare etj. të cilat vazhdojnë të luajnë një rol në senzibilizimin e opinionit të përgjithshëm për rrezikun dhe dëmet që mund të shkaktojnë këto dukuri.

z. Faik Muçiqi, nëse nuk keni ka diçka rreth kësaj teme, kalojmë në pikën e radhës.

6. Të ndryshme

z. Faik Muçiqi, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi kemi disa ankesa, gjegjësisht shqetësime të qytetarëve, çështja ka të bëjë te parku, te Beni Dona, tre personat që janë me probleme mendore, rreth tyre është duke qëndruar një numër i madh i qenve endacak, kështu që qytetarët që po frekuentojnë parkun detyrohen të largohen me paraqitjen e tyre. kërkesa është të ndërmerret diçka ndaj këtyre personave me probleme mendore dhe për largimin e atyre qenve. Kurdo që jeni të gatshëm për të vepruar Policia do të jetë në asistim dhe përkrahje të institucioneve komunale.

Çështje tjetër që po na paraqet problem është shenjëzimi i parkingjeve për taksi të licencuar. Kërkesa është që sa më shpejtë të caktohet një lokacion për ato taksi, sepse janë duke parkuar vend e pa vend.

Çështje tjetër është Rregullorja për orar të punës së biznese. Ditën e diel që është ditë pushimi a është paraparë ndonjë market për gjëra ushqimore që do të jetë kujdestar, sepse ka ankesa të shumta nga qytetarët që nuk kanë ku të furnizohen me artikuj ushqimor, përveç furrave të bukës nuk ka ndonjë market të produkteve ushqimore. Ky është një shqetësim të cilin e kanë paraqitë qytetarët.

z. Faik Muçiqi, sa i përket qenve endacak unë dhe Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kemi dërguar shkresa zyrtare në AUVK lidhur me këtë çështje dhe ata kanë filluar me rregullimin e strehimores dhe presim të funksionalizohet te fshati Buricë, ndërsa Komuna ka bërë rregullimin e rrugës. Ndërsa sa i përket automjeteve taxi do të mundohemi të caktojmë disa vende, për arsye se punimet në shesh i kanë çrregullua bukur shumë. Ndërsa sa i përket kujdestarisë së ndonjë marketi ushqimor, kjo çështje është e rregulluar me Rregulloren për orar të punës së bizneseve.

Koordinatori përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut

Mbledhja përfundoi në orën 11.35

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-060/03-0032669/20

Podujevë, 01 korrik 2020

Nënkryetari i Komunës

Nexhmi Rudari